

progetto cofinanziato da



UNIONE
EUROPEA



MINISTERO
DELL'INTERNO

Fondo europeo per l'integrazione di cittadini di paesi terzi

KOMUNIKIM I RENDESHIEM

Komuna e Ravenes informon qe ne **muajin tetor 2011** do te filloje **Regjistrimi i Pergjithshem i Popullates** (i 15-ti), i detyrueshem per te gjithë qytetaret qe kane rezidencen ne Komune, italiane , te huaj, dhe qytetare te Komunitetit European. Duhet te plotesoni nje pyetesor te pergatitur nga ISTAT, i cili ka qellimin te marre informazione mbi numrin e banoreve dhe karakteristikat e popullates banuese ne secilen prej komunave.

Ne qofte se qytetari nuk ploteson pyetesorin ISTAT mund te humbe **rezidencen**.

Humbja e rezidences mund te sjelle shume pasoja nder te cilat, pershembull, nderprerjen e periudhes se nevojshme per kerkesen e nenshtetesise italiane, veshtiresine per te kerkuar asistencen ne sherbimet sociale, tarifa me te larta te faturave per gazin dhe elektricitetin, dhe te tjera akoma.

Ne qofte se qytetari refuzon te plotesoje pyetesorin ISTAT, eshte parashikuar dhe **gjoba**.

Nga mesi i muajit shtator 2011, te gjitha familjet do te marrin ne shtepi pyetesorin i cili duhet plotesuar **duke filluar nga data 9 tetor**, data zyrtare e regjistrimit te popullates.

Mund te plotesoni pyetesorin ne kompjuterin personal te lidhur me internetin ose mund te shkoni ne disa qendra , te krijuara enkas nga Komuna e Ravenes per te ofruar asistencen.

Alternativa tjeter eshte plotesimi me shkrim i pyetesorit i cili pastaj duhet te dorezohet ne qendrat e grumbullimit te Komunes apo ne pikat e grumbullimit te ngritura nga ISTAT.

Familjet qe kane nderruar adrese apo qe kane ardhur ne Komunen e Ravenes nga data 1 Janar 2011, mund te kompletone vetem pyetesorin qe Komuna do ti dergoje ne shtepi, duke filluar nga data 22 nentor 2011.

Gjate periudhes se rregjistrimit, per te ndihmuar qytetaret ne plotesimin e pyetesorit ne menyren on-line, Komuna e Ravenes ve ne dispozicion **QENDRAT E ASISTENCES** te cilave mund ti drejtoheni per te marre **informazione te metejshme**:

- Centro Immigrati del Comune di Ravenna, via Alberoni 16,
(nga e hena deri te premten nga ora 10 deri 13)
Casa delle Culture, piazza Medaglie D'Oro, 4,
(nga e hena deri te premten nga ora 10 deri 13)
- tel. 0544485302 ose 0544591876 nga ora 11 deri 13
- mail: centroimmigrati@comune.ra.it - casadelleculture@racine.ra.it

KUJDES POSTEN

Pyetesori do t'ju arrije ne shtepi nepermjet postes dhe do te permbaje kodet e nevojshme per plotesimin ne menyre on line

